



# FEDERATA E PAQES UNIVERSALE



Në fund u emëruan Ambasadorë të rinj për Paqen. Ata ndiheshin shumë të privilegjuar për këtë titull që po merrnin por dhe shumë përgjegjës për të kryer me sukses misionin e ri që morën. Mund të ndjehej sinqeriteti i tyre i pastër dhe zemra e tyre mirnjohëse.



## Ambasadorët e rinj të paqes

Ali Laho  
(Kryetar i Bashkisë Ersekë)  
Xhemal Dalipi  
(Këngëtar)  
Shpresa Cane  
(Përgjegjëse e Agjensisë së Sigurimit Shëndetësor, Ersekë)  
Lindita Beqo  
(Përgjegjëse e Zyrës Koordinim Zhvillimit, Bashkia Ersekë)  
Bylyre Jashari  
(Këngëtare dhe Valltare)

Ilir Qirjako  
(Trajner i ekipit të futbollit "Gramozi")  
Ervin Tane  
(Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Ersekë)  
Maksim Qirjazi  
(Gjyqëtar në Gjykatën e Shkallës së Parë, Korçë)  
Mimoza Tulina  
(Mjeke)  
Skënder Rustemi  
(Mësues)





# FEDERATA E PAQES UNIVERSALE

## Promovimi i Autobiografisë së Babait të Vërtetë në Qytetin e Ersekës

Në datë 26 maj 2012, u organizua Promovimi I Autobiografisë së Babait të Vërtetë në qytetin e Ersekës. Aktiviteti filloi të shtunën në orën 11 00 dhe u mbajt në ambjentet e Bibliotekës së qytetit nën kujdesin e vecantë të kryetarit të Bashkisë. Programi u hap me një video prezantuese të Federatës së Paqes Universale në botë dhe me një historik të shkurtër të F.P.U Shqipëri. Më pas Dr Niko Faber, kryetar i këshillit të FPU-së në Korçë, bëri një prezantim të gjithë aktiviteve lokale që janë zhvilluar gjatë vitit të kaluar.



Pjesa e fundit dhe me e rëndësishmja ishte prezantimi i librit autobiografik të Babait të Vërtetë “Si Qytetar Global Paqedashës”

Të gjithë referuesit prezantuan pjesë të vecanta të librit.

Për punën shpirtërore të BV referoi Msc Av Marilda Menkshi, për familjen dhe vecanërisht për Nënë e Vërtetë referoi znj. Klara Cela, për suksesin dhe vizionin ekonomik referoi Dr Niko Faber dhe për mesazhin që ju përcillet të rinjve në libër referoi një nga antarët tona, Marsela Matraku.

Nuk mund të lëmë pa përmendur dhe Prof.Dr Elfrida Zefin e cila është dhe nënkryetarja e këshillit të FPU,dega Korçë. Ajo përpara se të prezantonte emërimet e reja për ApP cilësoi BV si njeriun e Paqes i cili do të bashkojë të gjithë botën si një familje përqëndruar në një Zot.

Në fakt të gjithë ata që referonin të ngjallnin një emocion shumë të madh kur flisnin me pasion për Babain e Vërtetë.